



Deutsche Industrie- und
Handelsvereinigung in Albanien

DIHA – Përfaqësues të interesave gjermane në Shqipëri

Shqipëria ofron perspektiva interesante për investime, tregti dhe shërbime. Ekonomia shqiptare ka patur një rritje të fuqishme gjatë këtyre viteve. Investimet publike si dhe ato private nxisin atraktivitetin e Shqipërisë si një vend konkurrues në treg dhe si një qendër biznesi. Më tej vlen për t'u përmendur rritja e interesit të biznesit gjerman në Shqipëri. Si në sektorin e tregtisë, ashtu dhe në konsulencë e infrastrukturë po shtohet numri i kompanive gjermane dhe atyre shqiptare me partnerë gjermanë të cilat kërkojnë përfaqësues të interesave të tyre.

Në vitin 2008, me mbështetjen e Qeverisë Federale të Gjermanisë dhe organizatave Gjermane u formua Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri (Deutsche Industrie- und Handelsvereinigung in Albanien - DIHA). Ajo angazhohet si zëri i biznesit dhe i interesave gjermane në çështjet ekonomike.

Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë i fton kompanitë dhe personat e interesuar për pjesëmarrje aktive dhe mbështetje.

DIHA – Kush jemi ne

Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri është një shoqatë e pavarur e krijuar nga kompani të ndryshme në përputhje me të drejtën shqiptare, me seli në kryeqytetin e Shqipërisë – Tiranë.

Shoqata përfaqëson interesat e kompanive gjermane në Shqipëri si dhe mbështet kompanitë shqiptare të interesuara për kontakte dhe bashkëpunime me kompani në Gjermani.

DIHA – Çfarë duam ne

Qëllimi i DIHA-s është përmirësimi i kushteve ekonomike bazë për investime, tregti dhe shërbime në Shqipëri, si dhe zhvillimi i marrëdhënieve bilaterale ekonomike ndërmjet Shqipërisë dhe Gjermanisë. Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë është partner për grupet e ndryshme të interesit politik, ekonomik dhe grupe të ndryshme shoqërore në Shqipëri. Shoqata bashkëpunon ngushtë me institucionet e tjera si dhe shoqatat nga sfera ekonomike dhe shoqërore në Gjermani dhe Shqipëri.

DIHA – Çfarë bëjmë ne

- Përkrahje në marrëdhëniet ekonomike mes Gjermanisë dhe Shqipërisë.
- Përfaqësimi i interesave politike dhe ekonomike ndaj qeverisë, parlamentit, dhomave tregtare, shoqatave dhe mediave.
- Organizimi i aktiviteteve dhe takimeve për një dialog politik dhe për këmbimin e informacioneve dhe përvojave.
- Mbështetje për vendosjen e kontakteve të biznesit.
- Ofrimi i informacioneve dhe shërbimeve specifike për kompani të interesuara.
- Bashkëpunim me: Bashkimin e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë (UCCIAL), Shoqatën Ekonomike Gjermano-Shqiptare (DAW), Ambasadën e Republikës Federale të Gjermanisë në Shqipëri, Dhomat e Industrisë dhe Tregtisë Gjermane (DIHK) dhe Shoqatën Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) GmbH

Kryesia:

Presidente:	Stephanie Sieg	Tirana Business Park
Zv. Presidente:	Anette Kasten	Business Development
Përgjegjëse e Thesarit:	Ulrike Bega	Symbiotica - Zyrë Arkitekture dhe Urban Design
Anëtarët e kryesisë:	Bianca Duro	Austrian Institute of Excellence
	Simon Harm	Albanian Ferry Terminal Operator
	Leonardo Ceraku	PSZ Albania
	Patrick Martens	I Deleguari i Biznesit Gjerman për Maqedoninë, Shqipërinë dhe Kosovën
	Hans-Jürgen Müller	Shoqata Gjermano-Shqiptare e Ekonomisë, Berlin
	Fation Dervishi	GALA - German Albanian Logistics Agency sh.p.k.

Adresa e DIHA-s:

Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri (DIHA)
Rruga „Skënderbej“, P. 4/7
Tiranë
Shqipëri

Email: info@diha.al

URL: www.diha.al



Rregullorja e anëtarësimit/kuota

Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri, në përmbushje të detyrimeve të saj statutore, duke u bazuar në nenin 6 e më tej në nenin 10 të statutit, cakton për anëtarët e saj një kuotë anëtarësie.

(1) Çdo anëtar është i detyruar të paguajë shumën, e cila është e përcaktuar sipas kësaj rregulloreje anëtarësimi, në përputhje me vendimin e marrë gjatë Asamblesë së Anëtarëve.

(2) Pagesa vjetore e kuotës së anëtarësimit nga 1 janar 2009 kushton :

1.000,-- Euro

Anëtarët gëzojnë të drejtën, nëse dëshirojnë, të kontribuojnë me një shumë më të lartë anëtarësimi.

Ndërmarrjeve të vogla (deri në 10 punonjës) dhe personave fizikë u mundësohet, nëpërmjet paraqitjes së një kërkesë, ulje në pagesën e kuotës së anëtarësimit. Kjo shumë për ndërmarrjet e vogla është 500,-- Euro, dhe 250,-- Euro për personat fizikë, jo të lidhur me biznesin. Për uljen e kuotës së anëtarësimit vendos kryesia.

(3) Pagesa vjetore bëhet një herë në vit. Anëtarët lajmërohen gjatë tremujorit të parë të vitit kalendarik.

(4) Pagesa e kuotës së anëtarësimit për vitin e anëtarësimit bëhet në shumën e plotë brenda katër javësh nga momenti që kryesia e shoqatës ka konfirmuar anëtarësimin në DIHA. Pagesa e kuotës së anëtarësimit në vitet vijuese bëhet pas lëshimit të faturës.

(5) Ushtrimi i të drejtave të anëtarit bazohet në pagesat e rregullta të kuotës së anëtarësimit.

(6) Rregullorja e kuotës së anëtarësimit u miratua nga kryesia e DIHA-s më 4 Dhjetor 2008 në përputhje me vendimin e marrë nga asambleja e anëtarëve më datë 19 Gusht 2008.